

thirrje e hapur



REZIDENCA 17

Artist/e në rezidencë



Shtatëmbëdhjetë
Rr. Nazim Gafurri, nr. 271, Taslixhe
Prishtinë - Kosovë

+383 49 170078
www.foundation17.org
rezidenca@foundation17.org

Shtatëmbëdhjetë mirëpret aplikime nga artistë/e të medimeve të ndryshme, hulumtues/e, teoricient/e, shkrimtar/e, shkencëtar/e nga **Kosova** për qëndrim

1 - 3 muaj në Rezidenca 17, në kuadër të programit **INFRARED**.

Rezidenca e Artit **INFRARED** fokusohet në çështjet që kanë të bëjnë me ambientin dhe ka për qëllim të promovoj zhvillimin hulumtues dhe artistik rreth saj. **INFRARED** është zhvilluar duke u bazuar në natyrën e rrezes infra të kuqe e cila në përgjithësi është e padukshme për syrin e njeriut, por që mund të ndjehet si nxehtësi dhe mund të shihet vetëm nën rrethana të caktuara me pajisje të veçanta. Në të njëjtën vijë të mendimit, Rezidenca e Artit **INFRARED** aspiron përmes artit të identifikoj çështje emergjente të ambientit. Prandaj, përfshin të gjitha llojet e qasjeve për qëllim rezidencës përtej zhvillimit artistik. Në këtë mënyrë **INFRARED** përmes rezidencave mëton të krijoj dialog publik mbi çështjet e ambientit.

Ky program mbështet procesin e zhvillimit të një ideje hulumtuese apo eksperimentuese, organizimin e një bisede/prezantimi publik dhe qasje të hapur të punës përmes formatit të open-studio.

thirrje e hapur

REZIDENCA 17

Artist/e në rezidencë

INFRARED

Periudha e rezidencës

1 deri në 3 muaj | Prill - Qershor 2026

Diciplinat/mediumet

Artistë/e të të gjitha medimeve | Hulumtues/e | Teoricient/e
Shkrimtar/e | Shkencëtar/e

Studio/hapësirë pune

Dhoma e bashkëpunimit

Dhomat e studiove (3 dhoma)

- Interdisciplinary Room | Tavolina pune, Karrige, Llampë, Pajisje pune
- AV Room | Projektor, Kamerë, PC
- Printing Room | Printer 3D, Skaner, Printer bardh e zi dhe me ngjyra

Mbështetja financiare për projektin hulumtues | 800€ bruto

Informata rreth aplikimit

Për të qenë pjesë e programit të Rezidencës 17 i/e interesuari/a duhet të dorëzojnë CV, portfolio (për artistë/e) dhe një propozim të shkurtër (deri në 500 fjalë) rreth interesave mbi temën e ambientit.

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj deri me datën **15 mars 2026** në emailin rezidenca@foundation17.org



Shtatëmbëdhjetë
Rr. Nazim Gafurri, nr. 271, Taslixhe
Prishtinë - Kosovë


+383 49 170078
www.foundation17.org
rezidenca@foundation17.org

thirrje e hapur

REZIDENCA 17

Artist/e në rezidencë

INFRARED



Shtatëmbëdhjetë
Rr. Nazim Gafurri, nr. 271, Taslixhe
Prishtinë - Kosovë

+383 49 170078
www.foundation17.org
rezidenca@foundation17.org



Objekti njihet si shtëpia e shkrimtarit Hivzi Sulejmani, i cili aty shkroi tregimin e tij të fundit “Një gjeth e një njeri”.

Rezidenca 17 është program dinamik rezidencial i cili zbatohet përgjatë vitit, duke ftuar artistë/e, teoristë/e, shkrimtarë/e, shkencëtarë/e dhe hulumtues/e që të bëhen pjesë përmes thirrjeve të hapura. Përfshinë rezidenca tematike lokale, rezidenca shkëmbimore ndërkombëtare dhe qasje në studio pune të pajisura mirë. Këto rezidenca artistike mirëpresin lidhjet mes krijuesve, stimulojnë hulumtimin dhe mbështet procesin e krijimit apo ekzekutimit të një projekti a ideje të re krijuese.

Rezidenca 17 ofron tri studio pune, secila e pajisur për nevoja të ndryshme krijuese. Ky program në mënyrë aktive mbështet zhvillimin e një koncepti hulumtues apo eksperimental, prodhimi artistik, bisedave publike dhe prezantimeve në formatin e studiove të hapura. Aplikimet për shfrytëzimin e studiove janë të hapura përgjatë gjithë vitit. Rezidenca 17 po ashtu shërben si hapësirë për që akomodon aktivitete si punëtori, performanca, lexime dhe të tjera.

Në fund të vitit 2021 Shtatëmbëdhjetë nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Komunën e Prishtinës, duke siguruar kështu menaxhimin për një mandat 5-vjeçar të shtëpisë së Hivzi Sulejmanit në lagjen Taslixhe. Ky vend historik është një qendër e shtuar për programin e rezidencës artistike të Shtatëmbëdhjetë, duke evoluuar në një mjedis edukues për artistë/e, hulumtues/e, shkencëtarë/e, shkrimtarë/e, një platformë shkëmbimi dhe jo vetëm. Programi bazohet mbi bashkëpunimet ekzistuese dhe kultivon të reja, duke siguruar një të ardhme emocionuese për eksplorim artistik, krijues e shkencor, në hapësirë.

Programi i Rezidenca 17 mbështetet nga Fondacioni për Shoqëri Civile Kosovare (KCSF) përmes programit ‘EJA Kosovo’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Po ashtu nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe Komuna e Prishtinës.